



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Numër: 02-01/26

Datë: 08.06.2026

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Nënkryetari i Komunës së Junikut, në cilësinë e koordinatorit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi bënë këtë:

FTESË

- Për:** Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Nga:** z. Besart Tofaj - Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Përmes:** z. Ruzhdi Shehu - Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Lënda:** Mbledhja (dytë) e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Vendi:** Objekti i Kuvendit Komunal Junik (Salla e takimeve);
- Data e takimit:** 15.06.2026, në ora 14:00.

Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026,
4. Të ndryshme.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-01/26

Datë: 14. 05. 2026, ora 14⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbledhja e Parë e Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 14 Maj 2026, në orën 14⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Besart Tofaj - Nënkyetar i Komunës - Koordinator i KKSB-së,
2. Rasim Sylja - Komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Liberta Hoxha - Zyrtare për Barazi Gjinore,
4. Xhavit Velijaj - Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
5. Florant Pepshi - Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
6. Blerina Sallaj - Përfaqësuese e Këshillit Lokal për Siguri Publike,
7. Guxim Gjocaj - Përfaqësues nga Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
8. Shkëlzen Shehu - Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
9. Zeqë Shehu - Përfaqësues nga OJQ,
10. Leonita Jasiqi - Përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
11. Haki Jasiqi - Përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit,
12. Qamil Jasiqi - Përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara,

Në këtë mbledhje munguan; Vedat Shatri - përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Imer Krasniqi - Përfaqësues i Bashkësisë Islame, Floris Miroci - kryesuese e Komitetit për Komunitete, Driton Sylja - “Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik dhe Alban Miroci - përfaqësues i mediave lokale.

Mbledhjen e Parë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026 e shpalli të hapur koordinatori i KKS-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Konstituimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Formimi i grupit punës për hartimin e planit të punës
4. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua me 12 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Pika e Parë të Rendit të Ditës **Konstituimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Koordinatori z. Besart Tofaj sqaroi procedurat dhe bazën ligjore mbi KKS-të dhe e konstatoi të konstituar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës **Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut**

Komandanti i Policisë në Junik, z. Rasim Sylja, tha se Policia është në shërbim të qytetarëve 24/7. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut që nga takimi i fundit, në përgjithësi, është e qetë dhe nuk kemi pasur ndonjë rast të veprave të rënda penale apo vepra të tjera të asnjë lloji, gjë që është një imazh i mirë për Komunën e Junikut. Kemi pasur shumë aktivitete policore që kanë ndikuar në një situatë të qetë të sigurisë publike, kryesisht me rregullimin e trafikut, ku mund të vërehet një përmirësim i theksuar. Ai theksoi se punojnë në fusha të ndryshme si në parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve, por edhe në aktivitete të tjera që janë në kompetencë të policisë.

Zeqe Shehu tha se e përgëzon Policinë që ofron siguri tek nxënësit. Çdo ditë një patrullë e policisë është prezente, por kërkoj që kjo patrullë të jetë prezente edhe pasdite, atëherë kur nxënësit lëshohen nga shkolla, kryesisht nga ora 13:00 deri 13:30, pasi nganjëherë ka vozitje të rrezikshme nga disa të rinj. Lidhur me këtë kërkesë, komandanti Rasim Sylja tha se, në bazë të kapaciteteve të stafit, do të jenë prezent afër shkollave edhe pasdite në orarin e kërkuar, me një patrullë të policisë.

Haki Jasiqi pyeti se sa mjete motorike janë konfiskuar dhe nëse po respektohet orari i ndalimit të kalimit të mjeteve të rënda në rrugën që çon te shkolla fillore. Komandanti Rasim Sylja u përgjigj se paraprakisht kanë bërë një fushatë vetëdijesimi rreth këtyre mjeteve dhe tha se aksioni i konfiskimit të mjeteve motorike (motocikleta) pa regjistrim dhe dokumente përkatëse ka filluar dhe po vazhdon. Ndërsa sa i përket orarit të ndalimit të qarkullimit të mjeteve të rënda, theksoi se disa kompani lokale kanë leje për lëvizje. Haki Jasiqi tha se e përgëzon Policinë për nismën për konfiskimin e motoçikletave dhe se vërehet një përmirësim në këtë pikë.

Xhavit Velijaj ngriti çështjen nëse janë duke u marrë masa rreth mos përdorimit të helmetave nga biçiklistët, motoristët dhe personat që përdorin trotinetët elektrikë, sepse shpeshherë kemi lëndime të fëmijët, por edhe të rriturit, nga mos përdorimi i helmetave. Ai kërkoj nga Policia që të mos lejohet

lëvizja pa vendosur helmetat. Komandanti Rasim Syla tha se Juniku është tash një atraksion për përdorimin e motoçikletave për shkak të asfaltimit të rrugës për në Bjeshkët e Junikut, e sidomos në fundjavë, pra të shtunën e të dielën, dhe se në veçanti në këto ditë bëjnë shtesë pika kontrolli. Ai shtoi se kanë biseduar edhe me kompanitë që japin motoçikleta me qira se duhet t'i pajisin me helmeta të gjithë klientët e tyre.

Haki Jasiqi ngriti shqetësimin në lidhje me mosfunksionimin e ndriçimit publik në një pjesë të qendrës së Junikut. Nënkryetari Besart Tofaj tha se kanë kufizime buxhetore për shkak se shumë mjete janë marrë nga përmbaruesi për kontratën kolektive, por se tashmë është bërë një zgjidhje dhe është kontraktuar kompania që së shpejti do të ndërhyjë për ta rregulluar ndriçimin në një pjesë të qendrës së Junikut.

Blerina Sallaj tha se duhet edukim të fëmijët, mbase edhe në shkolla, rreth mënyrës së përdorimit të trotinetit por edhe biçikletës, dhe shtoi se KLSP mund të ofrojë një trajnim të tillë në bashkëpunim me shkollat.

Çështjen e njëjtë e adresoi edhe Zeqe Shehu, duke thënë se në Evropë fëmijët e mbajnë një trajnim dhe më pas pajisen me një leje për përdorim të biçikletave.

Komandanti tha se ata mbajnë ligjërata në shkolla, në të gjitha nivelet shkollore, lidhur me sigurinë në trafik dhe se aty trajtohet edhe kjo temë. Por, në kuadër të policisë nuk ka ndonjë program specifikisht për trajnim dhe pajisje me ato leje. Ai theksoi se duhet edhe angazhim nga prindërit, që të mos i lejojnë fëmijët të dalin në rrugë pa njohuri për biçikletën dhe pa helmeta.

Leonita Jasiqi tha se edhe Policia duhet ta bëjë punën e vet, por që barra kryesore bie mbi familjen në lidhje me edukimin e fëmijëve në secilën fushë të jetës.

Nënkryetari Besart Tofaj e përgëzoi Policinë për aksionin për lirimin e trotuareve nga makinat në zonën e qendrës, por kërkoi që ky aksion të vijojë edhe në pjesë të tjera të qytetit, e posaçërisht tek rruga Junik – Restovicë. Duke ditur që tashmë Policia i ka të gjitha rrugët dhe udhëkryqet nën mbikëqyrje, kjo falë edhe donacionit të fundit që kemi pranuar nga KFOR-i, ai kërkoi nga Komandanti që Komuna të informohet në momentet e para të ndonjë defekti eventual në kamera.

Zeqe Shehu kërkoi që Komuna t'i rregullojë shenjat e trafikut dhe të ndërtojë e të parasheh edhe shenja për ndalim parkimi, pasi çdo shenjë vlen deri në udhëkryq. Ai shtoi se edhe tek shkolla duhet të vendosen tabela "Kujdes shkolla".

Blerina Sallaj pyeti se a monitorohen kamerat gjatë gjithë kohës apo vetëm në raste të caktuara nga Gjykata.

Komandanti Rasim Syla tha se monitorimi dhe qasja në kamerat që posedon Policia janë të rregulluara me procedura dhe me ligj.

Qamil Jasiqi theksoi se është shqetësuese që gjatë procesit mësimor shihen nxënësit jashtë oborrit të shkollës, të cilët mund të jenë duhanpirës, dhe kërkoi që kjo çështje të adresohet. Ai gjithashtu theksoi mungesën e parkingjeve në zonën e qendrës.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se mungesa e parkingjeve është evidente, pasi aktualisht edhe parkingu i Komunës shfrytëzohet nga stafi dhe nga qytetarët, por që kjo nuk është në rregull, pasi është parking i dedikuar vetëm për automjete zyrtare. Ai shtoi se as stafit nuk i lejohet përdorimi i tij, por që kanë marrë vendim të lirohet edhe për qytetarët, për shkak të mungesës së alternativave të tjera për parking.

Florant Pepshi theksoi nevojën e ndryshimit të orarit të autobusit që sjell nxënësit në shkollën fillore, pasi aktualisht ata arrijnë thuajse në të njëjtin orar kur prindërit e tjerë sjellin fëmijët në shkollë. Për shkak të rrugës së ngushtë nga qendra deri te shkolla, po krijohen shumë kolona dhe vonesa.

Zeqe Shehu tha se këtë çështje e kanë diskutuar si shkollë edhe me operatorin ekonomik, që të ndryshojë rrugën gjatë vijës së dytë të ardhjes së nxënësve, për të liruar sado pak qarkullimin e rrugës nga qendra deri te shkolla fillore.

Haki Jasiqi tha se çështja e rrugës nga qendra deri te shkolla është diskutuar shumë herë dhe, fatmirësisht, nuk kemi pasur aksidente, por mbështeti propozimin që kjo rrugë të frekuentohet me më shumë radhë edhe nga prindërit.

Komandanti Rasim Sylja tha se prindërit kanë mundësi që kthimin nga shkolla ta bëjnë në rrugë të tjera, pasi ka shumë alternativa, dhe kjo do ta lironte sado pak rrugën. Ai shtoi se Policia do të shikojë bazën ligjore për të vendosur shenja mobile, në mënyrë që ta bëjë atë rrugë me një drejtim për një orar të caktuar.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës **Formimi i grupit për hartimin e planit të punës**

Nënkryetari z. Besart Tofaj propozoi një grup punues prej 5 anëtarësh për hartimin e planit të punës së KKSB-së për vitin 2026. Grupi punues i propozuar është:

- Besart Tofaj – Kryesues
- Xhavit Velijaj – Anëtar
- Florant Pepshi – Anëtare
- Liberta Hoxha – Anëtare
- Leonita Jasiqi – Anëtare

Ky propozim u hodh në votim dhe me 12 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime u miratua.

Pika e Katër e Rendit të Ditës **Të ndryshme**

Nënkryetari z. Besart Tofaj njoftoi se kompensimi i anëtarëve të disa komiteteve ende nuk është i rregulluar me ligj. Në Asamblenë Komunale është marrë një vendim, por ende nuk është marrë përgjigja nga MAPL lidhur me ligjshmërinë e atij vendimi.

Florant Pepshi tha se duhet të kompensohet edhe KKSB-ja, ashtu sikurse KPF.

Nënkryetari tha se ligji parasheh kompensimin vetëm për anëtarët e Kuvendit që marrin pjesë në ato komitete. Ai shtoi se e njëjta situatë ekziston edhe në Komitetin për Komunitete, ku anëtarët e Kuvendit kompensohen, ndërsa anëtarët e tjerë nuk kompensohen brenda të njëjtit komitet.

Qamil Jasiqi tha se nuk mendon se duhet të jetë problem, pasi 1–2 orë kontribut e kemi obligim ndaj vendit.

Blerina Sallaj theksoi se së bashku prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit vitin e kaluar kanë mbajtur trajnim për shëndetin mendor. Ajo shtoi se e njëjta organizatë do të hartojë një strategji për parandalimin e vetëvrasjeve në Kosovë, ku do të merren komente dhe sugjerime edhe nga institucionet publike komunale.

Haki Jasiqi kërkoi që të bëhet pastrimi i rrugëve publike me ujë, e sidomos në zonën e qendrës së Junikut, në baza javore.

Me kaq, nënkryetari Besart Tofaj e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi,

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së

Esat Hoxha

Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Plani Vjetor i Punës së KKSBB-së, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSBB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrative për KKSBB-në.

Roli i KKSBB-së në komunën tonë është i rëndësishëm sepse grumbullon shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.

KKSBB në Junik drejtohet nga kryetari i komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu në bashkëpunim të ngushtë me komandantin e policisë së Junikut z. Rasim Sylja dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e bashkësive fetare myslimane, përfaqësues të organizatave jo qeveritare, të biznesit dhe ekupe për siguri publike në bashkësi, nën monitorim autoriteteve nacionale siç është Departamenti i Sigurisë Publike dhe autoriteti i inspektoratit të policisë si dhe të organizatave të ndërkombëtare si OSBE, KFOR dhe UN.

Nëpërmjet KKSBB-së arrihet të kuptohen shqetësimet e të gjithë qytetarëve në komunën e Junikut dhe të ndërmerren hapa konkret për zgjidhjen e atyre problemeve. Duke qenë të bindur në rolin e rëndësishëm që ka KKSBB, komuna e Junikut është në maksimum e përkushtuar që plani i punës së KKSBB-së të zbatohet me përpikëri.

Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSBB themelohet me vendim të kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Mandati i KKSBB-së është 4 vite dhe korrespondon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunës. Në mënyrë që me sukses të kryej misionin e vetë, duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSBB duhet të përpilojë dhe ta miratojë planin e punës për vitin vijues. Pas miratimit të planit të punës nga vetë KKSBB, plani prezantohet dhe shqyrtohet edhe në kuvendin e komunës përkatëse.

Qëllimi i planit të punës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këtë plan, por do të jetë aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre. Plani i punës i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematika të cilat e prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve.

Objektivat

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL KKSB duhet të mbaj së paku 6 mbledhje gjatë vitit. Në këto mbledhje shqyrtohen problem të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve. Duke u bazuar në këto udhëzime, KKSB në Junik për vitin 2026, përveç mbajtjes së 6 mbledhjeve të obligueshme, synon që të shqyrtojë këto çështje të sigurisë:

Aktivitetet

Për t' arritur këto objektiva, Anëtarët e KKSB do të ndërmarrin këto aktivitete:

1. Do të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen e sigurisë në të gjithë territorin e komunës;
2. Do të mbledhin shënime, fakte dhe do të raportojnë në mbledhjet e KKSB-së për secilin problem të vëzhguar, dëgjuar apo supozuar;
3. Do të mbajnë takime me qytetarë, këshilla shkollore, grupe qytetarësh, organizata joqeveritare (OJQ) dhe do të dëgjojnë problemet e tyre;
4. Do të adresojnë problemet dhe sfidat në organet kompetente, si dhe krijimin e partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
5. Do të mbajnë evidenca për problemet e shqyrtuara dhe për progresin e arritur në zgjidhjen e problemit;

Rezultatet e pritura

Duke vepruar siç është cekur më sipër dhe duke u përqendruar në objektivat e shënuara më sipër situata do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Për qytetarët do të sigurohet më shumë siguri në të gjitha fushat.

PLANI I PUNËS SE KKSb-së PËR VITIN 2026

Në formë tabelore paraqitet si:

Kategorizimi	Nr	Temat për shqyrtim	Bartësit	Periodha e raportimit
Shëndetësia	1	Raport mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Junikut; Kodi i Etikës, personeli mjekësor, sjellja e mjekëve dhe asistentëve nëpër institucione dhe ordianca mjekësore; Gjendja me barna dhe materiale esenciale në QKMF.	Drejtori i QKMF-së – Junik; Policia e Kosovës; Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Junikut;	Maj
	2	Vetëdijesimi për rreziqet nga kafshët e egra dhe zvarranikët.	Drejtorja Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale; Drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;	Shtator
	3	Shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut;	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Junikut; Drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;	Shtator
Kamerat e Qytetit	4	Kamerat e qytetit dhe në Institucionet publike;	Informatë nga Policia e Kosovës dhe drejtoritë komunale;	Maj, Dhjetor
Arsimi	5	Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore;	Të raportohet nga Drejtori i DKA-së, këshilli i prindërve, psikologët e shkollave ose pedagogët;	Qershor
Ambient	6	Mbrojtja e burimeve ujore dhe lumenjeve që rrjedhin në komunën e Junikut, deponitë ilegale, mbeturinat;	Të ftohen në bashkëbisedim: Drejtorja e Shërbimeve Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorja e Urbanizmit dhe Policia.	Nentor
	7	Parandalimi i aktiviteteve të paligjshme në pylltari, gjueti, peshkim dhe bletari.	Drejtori për Zhvillim Ekonomik; Agjencioni pyjor; Drejtorja për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim;	Nentor
Mjedisi Urban	8	Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi dhe pengesat në rrjedhat e lumenjeve, përrockave dhe kanaleve; Gjelbërimi;	Të ftohen në bashkëbisedim nga Kompania Rajonale për mirëmbajtjen e kanaleve; Drejtori për Zhvillim Ekonomik; Drejtorja për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim;	Dhjetor

Siguria	9	Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;	Të ftohen në bashkëbisedim nga Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim; AVUK;	Dhjetor
	10	Zjarret fushore dhe malore, pengesat për qasje të zjarrfikësve;	Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim; Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim; AME	Qershor
	11	Dëmtimi i shtëpive, vjedhja e gjësendeve, siguria në Komunën e Junikut;	Të ftohet në bashkëbisedim përfaqësuesit e institucioneve komunale si dhe autoritetet qendrore; Agjencioni i Veterinarisë;	Dhjetor
	12	Siguria në trafik, parkingjet, sinjalizimi, sanimi i rrugëve dhe ndriçimi publik;	Drejtorja për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim;	Shtator, Dhjetor
Të Drejtat e Njeriut	13	Mbrojtja e grupeve të marginalizuara të cilët mund të privohen nga të drejtat themelore; Radikalizimi; Dhuna në familje;	Të ftohen në bashkëbisedim institucionet, OJQ që merren me çështje të dhunës në familje dhe të ngjajshme; Drejtoria Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale;	Qershor, Dhjetor
	14	Ri integrimi i personave të riatdhesuar;	Të ftohet në bashkëbisedim IOM dhe organizatat tjera që e trajtojnë këtë çështje;	Nentor
Raportimi dhe Plani i Punës	15	Raportim në Kuvendin Komunal për aktivitet e zhvilluara nga KKSBB-së për vitin 2026 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2027;	Raportim i vjetor të KKSBB-së për vitin 2026; Hartimi i Planit të Punës për vitin 2027;	Dhjetor

Afati kohor

Plani i punës Janar deri më Dhjetor 2026.

Përmbledhje

Në këtë plan të punës janë paraqitur informacione për KKSBB-në, aktet që e rregullojnë veprimtarinë e saj. Po ashtu është paraqitur qëllimi i planit të punës, objektivat e planit, aktivitetet që do të ndërmerren nga anëtarët e KKSBB-së për t'i arritur objektivat si dhe janë paraqitur rezultatet e pritura dhe afatet kohore.